



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
dhe
AVOKATI I POPULLIT**



AVOKATI I POPULLIT



Nr. 363 Prot. Nr. Dok.

Tiranë, më 26.06. 2023

Nr. 787 prot.

Tiranë, më 26.06. 2023

Lënda: Rekomandim i përbashkët i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit për marrjen e masave dhe zbatimin e legjislacionit përkatës për sigurimin e përfaqësimit të barabartë gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri.

BASHKISË BELSH
Rruga "Haziz Dervishi",
BELSH

BASHKISË BERAT
Rruga "Antipatrea",
BERAT

BASHKISË BULQIZË
Lagjja "Minatori",
BULQIZË

BASHKISË CËRRIK
Lagja Nr. 2, Rruga "Bulevardi Gjumnazi 1962",
CËRRIK

BASHKISË DELVINË
Lagjja "Sinan Ballaci," Rruga "Nazif Hadëri",
DELVINË

BASHKISË DEVOLL
Lagjja Nr.1, Rr. "24 Tetori", Nr. 9,
DEVOLL

BASHKISË DIBËR

Bulevardi Elez Isufi,
PESHKOPI

BASHKISË DIMAL

Rruga "Dimal", Lagjja "18 Tetori",
URA VAJGURE

BASHKISË DIVJAKË

Pranë Sheshit "Santa Barbara",
DIVJAKË

BASHKISË DROPULL

Jergucat,
GJIROKASTËR

BASHKISË DURRËS

Sheshi "Liria", 2000,
DURRËS

BASHKISË ELBASAN

Rruga "Qemal Stafa",
ELBASAN

BASHKISË FIER

Lagjja "Kryengritja e Fierit", Rruga "Ramiz Aranitasi",
FIER

BASHKISË FINIQ

Finiq,
DELVINË

BASHKISË FUSHË-ARRËZ

Rruga Qendër,
FUSHË ARRËZ

BASHKISË GJIROKASTËR

Sheshi "Çerçiz Topulli",
GJIROKASTËR

BASHKISË GRAMSH

Sheshi "Kamber Dermushi", Lagjja "Holta", Rruga "10 Korriku", Kati I,
GRAMSH

BASHKISË HAS

Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati Kulturës, "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë,
HAS

BASHKISË HIMARË

Spile,
HIMARË

BASHKISË KAMËZ

Bulevardi "BLU", Nr. 492,
KAMËZ

BASHKISË KAVAJË

Bulevardi "Josif Buda",
KAVAJË

BASHKISË KËLCYRË

Sheshi "Musa Fratari",
KËLCYRË

BASHKISË KLOS

Klos,
MAT

BASHKISË KOLONJË

Sheshi "Rilindja",
KOLONJË

BASHKISË KONISPOL

KONISPOL

BASHKISË KORÇË

Lagjja nr. 12, Bulevardi "Shën Gjergji", Kodi Postar 7001,
KORÇË

BASHKISË KRUIJË

Sheshi "Skënderbej",
QENDËR KRUIJË

BASHKISË KUÇOVË

Blloku Nr.1, Lagja "Tafil Skendo",
KUÇOVË

BASHKISË KUKËS

Sheshi "Skënderbej", Lagjja 5,
KUKËS

BASHKISË KURBIN

Lagja Nr. 3,
LAÇ

BASHKISË LEZHË
Lagjja “Skënderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”,
LEZHË

BASHKISË LIBOHOVË
Rruga “Avni Rustemi”,
LIBOHOVË

BASHKISË LIBRAZHD
Sheshi “Gjorg Golemi”,
LIBRAZHD

BASHKISË LUSHNJË
Lagjja "Kongresi i Lushnjes", 9001
LUSHNJË

BASHKISË MALËSI E MADHE
Koplik Qendër,
MALËSIA E MADHE

BASHKISË MALIQ
Bulevardi “Rinia”,
MALIQ

BASHKISË MALLAKASTËR
Lagjja “18 Prilli”,
BALLSH

BASHKISË MAT
Sheshi “Ahmet Zogu”,
BURREL

BASHKISË MEMALIAJ
Rruga “Tafil Buzi”, Godina Nr.7,
MEMALIAJ

BASHKISË MIRDITË
Rruga “Atë Gjergj Fishta”,
RRËSHEN

BASHKISË PATOS
Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”,
PATOS

BASHKISË PEQIN
Bulevardi “Mustafa Gjinishi”,
PEQIN

BASHKISË PËRMET
Shëtitorja "Abdyl Frashëri",
PËRMET

BASHKISË POGRADEC
Bulevardi "Rreshit Collaku",
POGRADEC

BASHKISË POLIÇAN
Lagjia "Qendër" Poliçan, 5404,
POLIÇAN

BASHKISË PRRENJAS
Rruga "Skënderbej",
PRRENJAS

BASHKISË PUKË
Sheshi "Tërbuni",
PUKË

BASHKISË PUSTEC
Pustec,
KORÇË

BASHKISË ROSKOVEC
Lagja Nr. 1, Qendër,
ROSKOVEC

BASHKISË RROGOZHINË
Lagjia Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori",
RROGOZHINË

BASHKISË SARANDË
Rruga "Abedin Dino",
SARANDË

BASHKISË SELENICË
SELENICË

BASHKISË SHIJAK
Lagjia "Erzen",
SHIJAK

BASHKISË SHKODËR
Rruga "13 Dhjetori", Nr. 1,
SHKODËR

BASHKISË SKRAPAR

Lagjja "Çlirimi", Rruga "Pasho Hysi", Çorovodë,
SKRAPAR

BASHKISË TEPELENË

Rruga "Ali Pashë Tepelena", Sheshi "Lord Bajron",
TEPELENË

BASHKISË TIRANË

Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001,
TIRANË

BASHKISË TROPOJË

Sheshi "Azem Hajdari", Bajram Curri,
TROPOJË

BASHKISË VAU I DEJËS

Rruga "Qafa e Gurit",
VAU DEJËS

BASHKISË VLOREË

Sheshi "4 Heronjtë",
VLOREË

BASHKISË VORË

Rruga "Unaza", Nr. 73,
VORË

Për dijeni: **KUVENDIT TË SHQIPËRISË**
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
TIRANË

KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
TIRANË

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
TIRANË

**KËSHILLIT KONSULTATIV - AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E
VETËQEVERISJES VENDORE**
AMVV, Bulevardi Zhan d'Ark, Ish Shtëpia e Ushtarakëve
TIRANË

Të nderuara/të nderuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, në kuadër të:

ushtrimit të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;

zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “dh”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon: “Komisioneri ka kompetencë:... të monitorojë zbatimin e këtij ligji si dhe të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon: “Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente...”;

zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “f”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon: “Komisioneri ka kompetencë të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”;

Nxitjes së parimit të barazisë dhe ndalimin e çdo lloj diskriminimi,
dhe

Avokati i Popullit, si një institucion i pavarur kushtetues, që ushtron funksionet e tij, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe në këtë kontekst dhe mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave shqiptare, si pjesë e pandashme e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës sipas së cilës “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”; si dhe nenin 30 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” i cili shprehimisht parashikon se, “në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat joqeveritare, duke marrë periodikisht mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut”,

në konsultim dhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe lokale të cilat operojnë në fushën e barazisë gjinore në Shqipëri, parashitjnë këtë Rekomandim për marrjen e masave dhe zbatimin e legjislacionit përkatës për sigurimin e përfaqësimit në masën mbi 30 për qind për secilën gjini në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri, si më poshtë:

I. QËLLIMI I REKOMANDIMIT

Në vijim të përfundimit të zgjedhjeve vendore të vitit 2023 në Shqipëri dhe shpërndarjes së mandateve të kryetareve/kryetarëve të njësive të vetëqeverisjes vendore, qëllimi i këtij rekomandimi është të sjellë në vëmendje të organeve të reja të vetëqeverisjes vendore, të dala nga këto zgjedhje, garantimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri.

Gjatë vitit 2019, në bashkëpunim me UN Women Shqipëri, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndërmorri për herë të parë iniciativën e realizimit të një studimi në lidhje me përfaqësimin e gruas në organet e emëruara të pushtetit vendor dhe realizoi Raportin “*Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në organet e emëruara të pushtetit vendor*”.

Ky raport paraqet situatën e njësive të vetëqeverisjes vendore (Bashkive) në lidhje me respektimin e Ligjit Nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” në kombinim me Ligjin Nr. 9970/2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”, duke konstatuar por dhe duke propozuar e rekomanduar zgjidhje për respektimin e kuotës gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri.

Gjithashtu, në bazë të raportit kombëtar “Barometri i Barazisë Gjinore” realizuar në vitin 2022 nga Bashki të Forta & Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje” rezulton se një pjesë e Bashkive ende nuk i përmbushin plotësisht detyrimet ligjore për përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave në strukturat drejtuese të emëruara. Për shembull, në 75% të Bashkive të Shqipërisë nuk është arritur të përmbushet përfaqësimi gjinor minimal prej 30% në pozicionet e administratoreve/administratorëve. Ndërkohë që vihet re një përpjekje për të plotësuar detyrimet ligjore, është e rëndësishme që fryma e barazisë gjinore dhe përfaqësimit të balancuar gjinor të përçohet në të gjitha strukturat vendimmarrëse në nivel vendor.

II. ANALIZA E LEGJISLACIONIT TË ZBATUESHËM

Në funksion të analizës juridike për hartimin e këtij Rekomandimi, referuar akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar, Shqipëria ka marrë përsipër detyrimin për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtën e grave për barazi dhe mosdiskriminim dhe të sigurojë zhvillimin dhe përparimin e grave me qëllim përmirësimin e pozitës së tyre për arritjen e barazisë *de facto* dhe *de jure* me burrat.

Megjithatë, qasja vetëm ligjore ka treguar se nuk mjafton për të garantuar barazinë substanciale midis grave dhe burrave. Në situata të caktuara dhe kur rezulton se gratë janë të nënpërfaqësuar, zbatimi i masave të veçanta të përkohshme ose veprimet pozitive duhen kuptuar si një domosdoshmëri për të siguruar barazinë substanciale midis grave dhe burrave në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Kuadri ligjor kombëtar dhe ai ndërkombëtar kanë parashikuar dispozita të veçanta për respektimin e parimit të barazisë në përfaqësimin e secilës gjini në organet e emëruara të pushtetit qendror dhe atij vendor.

Sipas Rekomandimit të Përgjithshëm nr. 25 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), mbi masat e veçanta të përkohshme, zbatimi i këtyre masave ndonëse shpesh korrigjon efektet e diskriminimit në të shkuarën kundër grave, detyrimi i shteteve anëtare të Konventës (*ku përfshihet edhe Shqipëria*) për të përmirësuar pozitën e grave me qëllim arritjen e barazisë *de facto* ose barazisë substanciale me burrat, qëndron pavarësisht nga ekzistenca e provave për një diskriminim në të kaluarën. Komiteti CEDAW thekson se shtetet që miratojnë dhe zbatojnë këto masa nuk janë duke diskriminuar burrat. Ky detyrim që Konventa vendos ndaj shteteve anëtare ka gjetur zbatim në legjislacionin kombëtar me Ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, neni 8 dhe neni 15, si dhe Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 11 të tij.

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995) u bënë thirrje shteteve të marrin të gjitha masat ligjore dhe zbatojnë masat e veçanta për përfaqësim të balancuar gjinor në të gjitha organet qeverisëse dhe publike.

Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm të OKB-së dhe specifikisht Objektivi Nr. 5 “Barazia Gjinore”, kërkojnë “Sigurimin e pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësi të barabarta në pozicione drejtuese në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike”.

Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, një dokument tepër i rëndësishëm i përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane¹, që merr vlerë të jashtëzakonshme sidomos aktualisht, në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit në BE, u drejtohet organeve të vetëqeverisjes vendore dhe rajonale në Evropë, të cilat ftohen ta nënshkruajnë dhe, përmes nënshkrimit, të shpallin zyrtarisht angazhimin e tyre publik ndaj parimit të barazisë së grave dhe burrave dhe të zbatojnë angazhimet e përcaktuara në këtë Kartë në mbarë territoret e tyre. Specifikisht nenet 2 dhe 3 të kësaj Karte theksojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në praktikë në qeverisjen dhe jetën publike të rajonit, bashkisë si dhe komunitetit vendor, duke patur parasysh dhe pjesëmarrjen nga grupet e pakicave.

Nënshkrimi nga ana e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe marrja e masave për zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore është përcaktuar si detyrim dhe në Qëllimin Strategjik IV të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030, miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021.

¹ Përgatitur dhe miratuar në vitin 2006 e rishikuar në vitin 2022. Shih: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/CEMR_European_charter_for_equality_EN.pdf

Neni 15 i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” parashikon se përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:

- sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;
- sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kritereve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;
- sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;
- sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.

Neni 11 i Ligjit 10221/ 2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon se masa e përkohshme, e veçantë që synon përshtetimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Ligji organik nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ka përfshirë në një sërë dispozitash të tij që lidhen me çështjen e barazisë gjinore në fushën e organeve të emëruara të pushtetit vendor dhe specifikisht ka miratuar dispozita të veçanta nxitëse të barazisë gjinore në këtë ligj. Më konkretisht:

Neni 9, pika 1 e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, parashikon: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës: d) krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore”.

Neni 54, geramat b) dhe i), e këtij ligji parashikojnë: “Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: ...b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;...

i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;...”.

Në nenin 59, pika 3 të tij parashikohet se: “Kryetari i bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i

zëvendëskryetarëve caktohet nga kryetari i bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga kryetari i bashkisë.”

Ndërsa në nenin 64, ndër kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë, parashikohet se:
Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

- e) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;
- ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative/lagjeve dhe i shkarkon ata;

Neni 70, pika 1, parashikon se: “Fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. Kryesia është organ këshillimor i kryetarit. Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhje të fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote. Përbërja e kryesisë së fshatit duhet të respektojë ligjin për barazinë gjinore. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga këshilli bashkiak përkatës”.

Neni 74, pika 5, parashikon: “Në mbledhjen e tij të parë këshilli i qarkut:

- a) zgjedh komisionin e mandateve, i cili verifikon mandatet e anëtarëve të këshillit;
- b) vërteton mandatet e anëtarëve të këshillit;
- c) zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kryesinë e këshillit të qarkut, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore”.

Neni 77, parashikon ndër të tjera se Këshilli i Qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh nga anëtarët e këshillit kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e kryesisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit të qarkut;

Gjithashtu, në frymën e standarteve ndërkombëtare si dhe legjislacionit të sipërcituar që parashikon detyrime ligjore për të garantuar barazinë gjinore në pushtetin vendor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit inkurajojnë zbatimin e parimit të barazisë dhe në rastet e emërimeve nga kryetaret/kryetarët në funksione të tjera. Kjo bazuar dhe në parashikimin ligjor të nenit 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi; g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil.”.

III. KONKLZIONI

Përsa më sipër, në mbështetje të Ligjit Nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, Ligjit nr. 9970/ 2008 “Për barazinë gjinore”, si dhe të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit, në bashkëpunim me organizatat mbështetëse të kësaj nisme:

REKOMANDOJNË:

- **Marrjen e masave nga të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për sigurimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri, në zbatim të legjislacionit shqiptar, si edhe në përputhje me dokumentat ndërkombëtare të nënshkruara e ratifikuara nga Shqipëria dhe frymën e Konventës CEDAW, për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në përfaqësimin e secilës gjini në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri.**

Lutemi përcjelljen e informacionit mbi veprimet e ndërmarra nga ana Juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi, brenda një afati sa më të arsyeshëm.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA



KOMISIONERI

Robert GAJDA



ORGANIZATAT MBËSHTETËSE:

1. Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje”
2. Aleanca e Kombëtare e Grave Këshilltare Bashkiake
3. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, AWEN
4. Women’s Democracy Network Albania
5. Aleanca Gjinore për Zhvillim

6. Qendra per Zhvillim Komunitar “Sot per te Ardhmen”
7. Aleanca e Grave dhe Vajzave te Zgjedhura ne Keshillat Vendore
8. Human Rights in Democracy Centre
9. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, UNDP Shqipëri
10. UNWomen Shqipëri
11. Helvetas Swiss Intercooperation
12. Olof Palme International Center
13. OSBE Prezenca në Shqipëri

